

# RAIFFEISEN BANK SH.A.

## Raporte Financiare 3-Mujore

Për periudhën e mbyllur më: 30/9/2019

Sipas Kerkesave te Rregullores Nr. 60, datë 29.08.2008 [i ndryshuar] te Bankes se Shqiperise

<b>PERMBAJTJA:</b>	<b>Faqe</b>
1. Bazat e pergatitjes dhe Permbledhje e Politikave Kontabel	1 - 6
2. Tregues te rentabilitetit te bankes	7
3. Pozicioni financiar, Pasqyra e te Ardhurave dhe zerat jashte bilanci te permbledhura	8 - 11
4. Pasqyra e ndryshimeve të kapitalit	12
5. Pasqyra e rrjedhjes së parasë	13
6. Klasifikimi i portofolit te kredive sipas shperndarjes gjeografike (rretheve)	14 - 15
7. Klasifikimi i portofolit te kredive sipas tipit te industrise dhene rezidenteve (rretheve)	16 - 17
8. Fondet per provigjone dhe levizjet gjate periudhes	18
9. Aktivitet sipas maturimit përfundimtar	19
10. Pasivet sipas maturimit përfundimtar	20
11. Struktura e kapitalit rregullator; Raporti i mjaftueshmërise së kapitalit: Kërkesa për kapital rregullator për mbulimin e rrezikut të tregut dhe rrezikut operacional	21

## **1. TË PËRGJITHSHME**

Raiffeisen Bank sh.a (“Banka”) është një institucion bankar i themeluar në përputhje me Ligjin 9901 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” datë 14 prill 2008 dhe me Ligjin 9662 “Për Bankat në Republikën e Shqipërisë” datë 18 dhjetor 2006 si edhe ligje të tjera të aplikueshme.

Bazuar në nenin nr.2 të Statutit të Bankës, objektivi i Bankës është të veproje, për llogari të vet apo të palëve të treta, çfarëdo dhe çdo operacion të pranuar apo të deleguar Bankës sipas legjislacionit përkatës. Raiffeisen Bank sh.a. është krijuar dhe themeluar si dhe operon vetëm në Shqipëri.

Raiffeisen Bank sh.a. është shoqëri e zotëruar nga Raiffeisen SEE Region Holding GmbH, Austri me 100 % të kapitalit.

Më 30 shtator 2019, Banka operon me një rrjet bankar prej 76 pika shërbimi në të gjithë Shqipërinë (31 dhjetor 2018: 76 pika shërbimi), të cilat drejtohen nga 6 Distrikte. Numri i punonjësve të Bankës më 30 shtator 2019 është 1,293 punonjës (31 dhjetor 2018: 1,273).

## **2. BAZAT E PËRGATITJES**

Pasqyrat financiare individuale të Bankës janë përgatitur në përputhje me “Metodologjinë e raportimit dhe përmbajtjen e raporteve financiare” (“Metodologjia e Raportimit Financiar” ose “MRF”) e miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë më 24 dhjetor 2008. MRF u miratua për qëllime rregullatore, në zbatim të Nenit 47 të Ligjit nr. 9662, datë 18 dhjetor 2006 “Për Bankat në Republikën e Shqipërisë”.

Pasqyrat financiare individuale janë prezantuar në Lekë Shqiptarë (“Lek”), të përafuar në mijë Lek dhe janë të përgatitura mbi bazën e kostos historike, përveç letrave me vlerë të disponueshme për shitje dhe letrave me vlerë të tregtueshme, të cilat vlerësohen mbi bazën e vlerës së tregut.

## **3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL**

### **3.1 Transaksionet në monedhë të huaj**

#### **(i) Monedha funksionale dhe prezantuese**

Pasqyrat financiare individuale janë prezantuar në Lek, cila është monedha funksionale dhe prezantuese e Bankës.

#### **(ii) Transaksionet në monedhë të huaj**

Transaksionet e kryera në monedha të huaj janë regjistruar fillimisht me kurset e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në këto monedha, janë rikonvertuar me kurset e këmbimit të datës së bilancit. Fitimet dhe humbjet që rezultojnë nga këmbimi janë paraqitur në pasqyrën individuale të të ardhurave. Aktivitetet dhe detyrimet jomonetare në monedha të huaja janë konvertuar me kurset e këmbimit të datës së transaksionit. Kapitali aksioner është konvertuar me kursin e këmbimit të datës së bilancit. Diferenca ndërmjet kostos historike dhe gjendjes duke përdorur kursin e këmbimit të datës së bilancit njihen si Diferenca nga Rivleresimi në Kapital.

Kurset e këmbimit që janë aplikuar më 30 shtator 2019 dhe 31 Dhjetor 2018 (Lek në monedhë të huaj) për monedhat e huaja kryesore janë paraqitur më poshtë:

	<b>30 shtator 2019</b>	<b>31 dhjetor 2018</b>
Dollari Amerikan (USD)	111.70	107.82
Monedha Europiane (EUR)	122.11	123.42
Paundi Britanik (GBP)	137.53	137.42

### **3.2 Arka dhe llogaritë me Bankën Qëndrore**

Për të raportuar fluksin e parasë, paraja dhe ekuivalentët e saj janë përcaktuar si arka dhe llogaritë me Bankën Qëndrore, duke përfshirë rezervën minimale të detyrueshme me Bankën e Shqipërisë (“Banka Qëndrore”).

Rezerva minimale e detyrueshme me Bankën e Shqipërisë është një rezervë që duhet ta mbajnë të gjitha bankat tregtare të licensuara në Shqipëri.

### **3.3 Investime në letra me vlerë**

Investime në letra me vlerë përfshijnë bono thesari, obligacione të Qeverisë dhe obligacione të huaja. Këto investime maten fillimisht me kosto, duke përfshirë kostot e transaksionit dhe klasifikohen si më poshtë:

- Letra me vlerë të mbajtura deri në maturim
- Letra me vlerë të disponueshme për shitje, dhe
- Letra me vlerë të tregtueshme

#### **(i) Letra me vlerë të mbajtura deri në maturim**

Letrat me vlerë që mbahen deri në maturim përfshijnë bono thesari dhe obligacione të qeverisë. Investimet që kanë pagesa fikse ose të përcaktuara dhe për të cilat Banka ka qëllimin dhe mundësinë për t'i mbajtur deri në maturim, regjistrohen pas njohjes fillestare me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, duke zbritur provigjonet për rënien në vlerë.

#### **(ii) Letra me vlerë të disponueshme për shitje**

Letrat me vlerë të disponueshme për shitje përfshijnë bono thesari dhe obligacione të huaja. Pas vlerësimit fillestar, letrat me vlerë, të cilat klasifikohen si të disponueshme për shitje, rivlerësohen me vlerën e tregut. Humbjet si rrjedhojë e ndryshimeve në vlerën e tregut të këtyre letrave me vlerë të disponueshme për shitje përfshihen në fitimin ose humbjen neto për periudhën në të cilën ndodhin këto ndryshime.

#### **(iii) Letra me vlerë të tregtueshme**

Letrat me vlerë të tregtueshme përfshijnë bono thesari. Letrat me vlerë të tregtueshme regjistrohen në ditën e blerjes dhe me çmimin e blerjes duke përfshirë kostot dhe interesin e përlllogaritur. Pas njohjes fillestare, letrat me vlerë të tregtueshme rivlerësohen me vlerën e tregut. Fitimet dhe humbjet si rrjedhojë e ndryshimeve në vlerën e tregut të këtyre letrave me vlerë përfshihen në fitimin ose humbjen neto të periudhës në të cilën ndodhin këto ndryshime.

#### (iv) Vlera e tregut

Vlera e tregut për letrat me vlerë që tregtohen në tregje financiare të organizuara përcaktohet duke iu referuar çmimeve të ofruara (bid) të kuotuar gjatë mbylljes së bursës në datën e bilancit. Për letrat me vlerë për të cilat nuk ekziston një çmim i kuotuar në bursë, një vlerësim i arsyeshëm i vlerës së tregut përcaktohet duke iu referuar vlerës aktuale të tregut të një instrumenti tjetër, i cili është i përafërt në natyrë. Vlera e tregut, gjithashtu, mund të bazohet në rrjedhjen e pritshme të parasë, ose mbi bazën neto të aktivitetit për letrën me vlerë në fjalë.

#### (v) Marrëveshjet e riblerjes dhe marrëveshjet e anasjellta të riblerjes

Letrat me vlerë të blera sipas marrëveshjeve për t'u rishitur (marrëveshje të anasjellta të riblerjes) dhe letrat me vlerë të shitura sipas marrëveshjeve për t'u riblerë (marrëveshje riblerjeje) në përgjithësi trajtohen si veprime financiare të kolateralizuara dhe mbahen me shumat e dhëna ose të marra, plus interesin e përlllogarit. Interesi nga marrëveshjet e anasjellta të riblerjes dhe për marrëveshjet e riblerjes shprehet si e ardhur ose shpenzim interesi gjatë kohëzgjatjes së çdo marrëveshjeje. Të gjitha këto marrëveshje bëhen me Bankën e Shqipërisë.

### 3.4 Huatë dhe paradhëniet për klientët

Huatë që Banka i jep huamarrësve duke i siguruar atyre para në mënyrë të drejtpërdrejtë, kategorizohen si hua të dhëna nga Banka dhe mbarten me vlerën e mbetur, pakësuar nga provigjionet për rënien në vlerë. Të gjitha huatë dhe paradhëniet kontabilizohen kur huamarrësve iu disbursohet shuma totale në para.

Përveç provigjioneve të përgjithshme të njohura në bilancin e Bankës, një provigjion për rënien e vlerës së huasë përcaktohet nëse është e qartë që Banka nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjithë shumën e pashlyer të detyrimit.

Politika huadhënëse e Bankës është në përputhje me ligjet në fuqi (Ligji për Bankat dhe Rregullorja e Bankës së Shqipërisë “Për Administrimin e Rrezikut të Kredisë nga Bankat dhe Deget e Bankave të Huaja” miratuar me vendimin nr. 62 datë 14.09.2011, ndryshuar me vendimin nr.27, datë 27.03.2013, ndryshuar me vendim nr. 22, datë 27.02.2014 dhe ndryshuar me vendim nr. 26, datë 01.04.2015 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë). Banka e klasifikon portofolin e huasë në pesë kategori duke aplikuar normat e mëposhtme për krijimin e fondeve rezervë të provigjioneve:

Kategoria e huasë	Provigjioni i humbjes
Standarde	1%
Në ndjekje	5%
Nënstandarde	20%
Të dyshimta	50%
Të humbura	100%

Kur huaja është e pakthyeshme, ajo anulohet me provigjionin për huatë e këqija, shumat e rikuperueshme më pas kreditohen në pasqyrën individuale të të ardhurave në zërin “Të ardhura / (shpenzime) të tjera operative”.

Banka nuk përlllogarit më interes mbi huatë e klasifikuara të humbura për shkak të falimentimit të klientit ose moskthimit në afat të huasë. Vlera e mbetur e huave, për të cilat nuk përlllogaritet interes, përfaqëson shumën për t'u marrë minus provigjionin për humbjet e pritshme. Provigjioni zakonisht përcaktohet si 100% e vlerës për t'u marrë.

### *Politikat e fshirjes së kredive*

Banka fshin një hua/letër me vlerë (dhe çdo provigjon për humbjet nga rënia në vlerë) kur Komiteti i Kredive Problematike të Bankës vendos që huatë/letrat me vlerë janë të paarkëtueshme. Ky përcaktim arrihet pasi janë marrë në konsideratë informacione si ndodhja e ngjarjeve të konsiderueshme, të cilat kanë ndikuar në gjendjen financiare të huamarrësit në mënyrë të tillë që ai nuk është në gjendje të paguajë detyrimin, ose të ardhurat nga ekzekutimi i kolateralit nuk do të jenë të mjaftueshme për të mbuluar ekspozimin total.

### **3.5 Mjetet e qëndrueshme të trupëzuara dhe të patrupëzuara**

Mjetet e qëndrueshme të trupëzuara dhe të patrupëzuara shprehen me koston historike të blerjes plus rivlerësimet (në rastin e ndërtesave) minus zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Ndërtesat shprehen me vlerat e rivlerësuara, të cilat janë vlerat reale në bazë të përdorimit aktual në datën e rivlerësimit, minus ndonjë zhvlerësim pasues të akumuluar dhe humbjet nga rënia në vlerë vijuese të akumuluar. Rezultati i rivlerësimit është paraqitur në rezervat e rivlerësimit.

Zhvlerësimi dhe amortizimi paraqiten si pakësim i koston së mjeteve të qëndrueshme të trupëzuara dhe të patrupëzuara kundrejt periudhës së vlerësuar të përdorimit të tyre, duke përdorur metodën lineare, me pikënisje nga muaji i vënies së tyre në përdorim dhe jetëgjatësitë të vlerësuar për periudhën aktuale dhe atë krahasuese janë si vijon:

	<b>30 shtator 2019</b>	<b>31 dhjetor 2018</b>
	<b>(në vite)</b>	<b>(në vite)</b>
• Ndërtesa	20	20
• Automjete	7	7
• Kompjuterat dhe pajisje informatike	4 deri në 7	4 deri në 7
• Software dhe Licensa	8	8
• Makineri dhe sisteme	7	7
• Pajisje për zyre dhe mobilje	5 deri në 7	5 deri në 7
• Përmirësimet e objekteve me qira	1 deri në 10	1 deri në 10

Toka dhe punimet në proces nuk zhvlerësohen.

Fitimet dhe humbjet nga shitja e ndërtesave dhe pajisjeve në përdorim paraqiten në pasqyrën individuale të të ardhurave në periudhën kur janë shitur ose nxjerrë jashtë përdorimit.

### **3.6 Pronat e rimarra në zotërim**

Në disa rrethana të caktuara, pronat e vëna në hipotekë mund të rimerren në zotërim pas heqjes të së drejtës mbi hipotekën e huave të këqija. Pronat e rimarra në zotërim vlerësohen me më të voglën midis vlerës së ankandit të fundit dhe vlerës së drejtë, pasi i janë zbritur kostot e shitjeve, dhe njihen në pasqyrat financiare individuale si “Aktive të tjera”. Qëllimi i Drejtimit ndaj pronave të rimarra në zotërim është shitja sa më e shpejtë e tyre, duke i përdorur të ardhurat nga shitja për uljen e borxheve të këqija.

### **3.7 Detyrimet ndaj klientëve**

Detyrimet ndaj klientëve shprehen në shumën e mbetur të principalit. Interesi është kontabilizuar mbi bazë përllogaritjeje.

### 3.8 Detyrimet ndaj institucioneve financiare

Detyrimet ndaj institucioneve financiare shprehen në shumën e mbetur të principalit. Interesi është kontabilizuar mbi bazë përlllogaritjeje.

### 3.9 Interesat dhe komisionet

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi janë regjistruar mbi bazë përlllogaritjeje.

Të ardhurat nga komisionet për llogaritë rrjedhëse, çeqet, transfertat e parave dhe transaksionet e tjera bankare regjistrohen si të ardhura kur arkëtohen. Komisionet për huatë shtyhen në kohë dhe njihen gjatë jetës së huasë. Shpenzimet e komisionit regjistrohen kur shpenzimet janë paguar.

### 3.10 Shpenzimet

#### (i) Shpenzimet operative

Shpenzimet operative regjistrohen kur ndodhin.

#### (ii) Përfitimet e punonjësve

- *Kontributi i detyrueshëm i sigurimeve shoqërore*

Banka derdh vetëm kontributin e detyrueshëm të sigurimeve shoqërore që siguron përfitim të pensionit për punonjësit kur dalin në pension. Qeveria e Shqipërisë ka përgjegjësi sigurimin e pragut minimal të pensionit në Shqipëri sipas një skeme pensioni me kontribut të përcaktuar. Kontributet e Bankës në skemën e kontributit të përcaktuar regjistrohen në pasqyrën individuale të të ardhurave kur ndodhin.

- *Leja vjetore e paguar*

Banka regjistron si detyrim koston e vlerësuar të paaktualizuar në lidhje me lejen vjetore që pritet të paguhet në këmbim të shërbimit të punonjësit për periudhën e mbyllur.

#### (iii) Përmirësimi i ambjenteve me qira

Përmirësimi i ambjenteve me qira shprehet me koston historike të blerjes minus zhvlerësimin e akumuluar. Zhvlerësimi llogaritet duke përdorur metodën lineare përgjatë periudhës së qirasë. Sipas rregullores së Bankës së Shqipërisë, vlera e mbetur e përmirësimit të ambjenteve me qira përfshihet në aktive të tjera.

### 3.11 Tatimi mbi fitimin

Tatimi mbi fitimin llogaritet 15% (31 Dhjetor 2018: 15%) mbi fitimin e tatueshëm në përputhje me legjislacionin tatimor shqiptar. Fitimi i tatueshëm llogaritet duke rregulluar fitimin para tatimit me disa të ardhura dhe shpenzime sipas kërkesave të legjislacionit shqiptar.

### **3.12 Pjesëmarrje në filial**

Banka zotëron 100% të aksioneve të Raiffeisen Leasing Sh.a. Raiffeisen Leasing Sh.a. është regjistruar në Regjistrin Tregtar Shqiptar sipas vendimit të Gjykatës së Tiranës Nr.35733 të datës 15 Maj 2006 dhe ushtron aktivitetin e qiradhënies financiare ashtu si parashikohet në legjislacionin shqiptar të aplikueshëm “Mbi Qiradhënien Financiare”.

Banka ka blerë 100% të aksioneve të Raiffeisen INVEST - Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive, Sh.a. Blerja është aprovuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare bazuar në vendimin nr 30, datë 26 Mars 2009, regjistruar në Qendra Kombëtare e Regjistrimit më 23 Prill 2009.

### **3.13 Vlerësimi i vlerës së tregut**

Duke qenë se për instrumentat financiarë të krijuara në Shqipëri nuk ekziston asnjë treg, vlerësimet e vlerës së tregut bazohen në gjykimet rreth pritjeve të ardhshme të humbjeve, kushteve aktuale ekonomike, karakteristikave të riskut të instrumentave të ndryshëm financiarë dhe në faktorë të tjerë. Të vetmet instrumenta financiarë të gatshëm për t'u tregtuar janë letrat me vlerë shqiptare.

Vlerësimet e vlerave të tregut bazohen mbi instrumentet financiarë të bilancit individual ekzistues pa vlerësuar këtu vlerën e biznesit të pritshëm si dhe vlerën e aktiveve dhe detyrimeve që nuk konsiderohen instrumenta financiarë. Aktive dhe detyrime të rëndësishme, që nuk konsiderohen instrumenta financiarë, përfshijnë pronat, pajisjet dhe aktivet e patrupëzuara.

Në përgjithësi, instrumentat financiarë të bilancit individual të Bankës kanë një vlerë të vlerësuar tregu afërsisht të barabartë me vlerën e tyre kontabël për shkak të natyrës së tyre afatshkurtër apo të normave bazë të interesit, të cilat përafrojnë me normat e tregut. Shumica e instrumentave financiarë monetarë, ose kanë norma interesi të luhatshme, ose riçmohen brenda vitit.

### **3.14 Përdorimi i vlerësimeve**

Përgatitja e pasqyrave financiare individuale në përputhje me MRF dhe Ligjin për Bankat në Republikën e Shqipërisë kërkon që organet drejtuese të bëjnë vlerësime dhe supozime, të cilat ndikojnë direkt në vlerën e raportuar të aktiveve dhe detyrimeve, në paraqitjen e vlerës së aktiveve dhe detyrimeve të mundshme në datën e përgatitjes së pasqyrave financiare individuale, dhe në shumën e të ardhurave dhe shpenzimeve gjatë periudhës raportuese. Rezultatet reale mund të ndryshojnë nga ato të parashikuara.

### **3.15 Krahasueshmëria**

Politikat kontabël të adoptuara nga Banka janë konsistente me ato të paraqitura një vit më parë, përveçse kur theksohet ndryshe.

## Tregues te rentabilitetit te bankes \*

Tregues te rentabilitetit te bankes *	30/9/2019	30/6/2019	31/3/2019	31/12/2018	30/9/2018	30/6/2018	31/3/2018	31/12/2017	30/9/2017
1. Kthyeshmëria nga aktivet mesatare (ROAA) [të ardhurat neto / aktivet mesatare *100];	2.2 %	2.2 %	2.1 %	2.7 %	3.0 %	3.2 %	2.8 %	2.1 %	2.0 %
2. Rezultati neto i jashtëzakonshëm / aktivet mesatare;	0.1 %	0.1 %	0.1 %	(0.1)%	(0.1)%	(0.1)%	(0.2)%	0.2 %	0.3 %
3. Shpenzimet e përgjithshme të veprimtarisë / të ardhurat bruto të veprimtarisë;	27.2 %	28.9 %	21.7 %	22.5 %	20.9 %	19.3 %	17.6 %	25.6 %	25.4 %
4. Të ardhurat neto nga interesi / shpenzimet e përgjithshme të veprimtarisë;	143.9 %	142 %	150 %	127 %	123 %	116 %	98 %	128 %	133 %
5. Kthyeshmëria nga kapitali aksionar mesatar (ROAE) [të ardhurat neto / kapitali aksionar mesatar *100];	17.9 %	17.6 %	17.7 %	22.7 %	25.5 %	28.0 %	25.1 %	23.8 %	23.6 %
6. Aktive për punonjës [totali i aktiveve / numri i regjistruar i punonjësve] në Lek'000;	174,027	173,748	179,614	176,970	177,056	185,332	189,832	195,287	186,839
7. Të ardhurat neto nga interesat / aktivet mesatare;	2.9 %	2.9 %	2.9 %	2.8 %	2.6 %	2.5 %	2.0 %	2.6 %	2.6 %
8. Marzhi neto nga interesat: [Të ardhurat neto nga interesat / aktivet mesatare qe sjellin te ardhura]	3.6 %	3.6 %	3.6 %	3.4 %	3.3 %	3.1 %	2.6 %	3.4 %	3.5 %
9. Te ardhurat nga interesat / aktivet mesatare;	3.0 %	3.1 %	3.0 %	3.3 %	3.3 %	3.3 %	3.5 %	3.1 %	3.2 %
10. Shpenzime për interesa / aktivet mesatare;	0.1 %	0.1 %	0.1 %	0.5 %	0.7 %	0.9 %	1.5 %	0.6 %	0.6 %
11. Të ardhurat neto nga interesat / të ardhurat bruto të veprimtarisë;	39.2 %	41.0 %	32.6 %	28.7 %	25.6 %	22.4 %	17.2 %	32.7 %	33.8 %
12. Të ardhurat neto nga veprimtaritë e tjera / aktivet mesatare;	1.2 %	1.2 %	1.0 %	1.3 %	1.3 %	1.2 %	1.0 %	1.3 %	1.0 %
13. Shpenzimet jo për interesa / të ardhurat bruto të veprimtarisë;	66.8 %	65.4 %	71.4 %	64.6 %	61.4 %	59.9 %	60.7 %	66.5 %	65.7 %
14. Shpenzime personeli / të ardhurat bruto të veprimtarisë;	13.7 %	13.8 %	10.7 %	10.7 %	9.5 %	8.6 %	7.7 %	11.7 %	11.4 %
15. Shpenzime për provigjone / aktivet mesatare.	-	-	-	-	-	-	-	-	-

(\* ) Treguesit jane llogaritur sipas kerkesave te Rregullores Nr. 60, datë 29.08.2008 te Bankes se Shqiperise (i ndryshuar)



## Pasqyra e pozicionit financiar dhe zërat jashtë bilanci

në mijë Lekë

<b>AKTIVET</b>	<b>30/9/2019</b>	<b>31/12/2018</b>	<b>Ndryshimi</b>	<b>ne %</b>
Arka dhe Banka Qëndrore	31,268,169	28,506,860	2,761,309	9.7 %
<i>Arka</i>	4,431,298	4,381,367	49,931	1.1 %
<i>Banka Qëndrore</i>	26,836,871	24,125,493	2,711,377	11.2 %
Bono thesari për rifinancim me Bankën Qëndrore	8,540,123	9,883,979	(1,343,857)	(13.6)%
Hua dhe paradhënie neto për institucionet e kreditit	23,982,327	29,677,301	(5,694,974)	(19.2)%
<i>Llogari rrjedhëse</i>	605,889	401,166	204,722	51.0 %
<i>Depozita</i>	19,127,527	26,386,715	(7,259,188)	(27.5)%
<i>Hua</i>	4,014,970	2,705,663	1,309,307	48.4 %
<i>Të tjera</i>	233,942	183,757	50,185	27.3 %
Hua dhe paradhënie neto për klientët	92,367,036	85,359,946	7,007,091	8.2 %
<i>Hua dhe paradhënie standarde</i>	85,801,683	79,478,868	6,322,815	8.0 %
<i>Hua të pakthyera në afat</i>	198,491	177,702	20,789	11.7 %
<i>Hua në ndjekje</i>	1,853,828	2,231,726	(377,897)	(16.9)%
<i>Hua nënstandard</i>	4,374,352	1,905,009	2,469,343	129.6 %
<i>Hua të dyshimta</i>	2,103,538	3,924,440	(1,820,902)	(46.4)%
<i>Hua të humbura</i>	6,445,235	7,455,574	(1,010,338)	(13.6)%
<i>minus fonde rezerve per huate</i>	(8,410,091)	(9,813,373)	1,403,282	(14.3)%
Letra me vlerë	60,493,180	65,115,332	(4,622,153)	(7.1)%
<i>Letra me vlerë me të ardhura të pandryshuara</i>	59,418,854	64,577,025	(5,158,171)	(8.0)%
<i>Letra me vlerë të blera sipas marrëveshjes (REPO)</i>	1,074,325	538,307	536,018	99.6 %
Interesa pjesëmarrëse dhe filialet	329,205	329,205	0	0%
<i>Filialet</i>	329,205	329,205	0	0%
Mjete të mbajtura në emër të të tretëve	0	0	0	0%
<i>Administrimi fiskal</i>	0	0	0	0%
Mjetet e qëndrueshme, neto	4,489,960	4,676,442	(186,482)	(4.0)%
<i>Mjete të trupëzuara</i>	1,201,915	1,312,623	(110,709)	(8.4)%
<i>Mjete të qëndrueshme në funksion të veprimtarisë</i>	3,134,611	3,216,134	(81,522)	(2.5)%
<i>Mjetet e trupëzuara të mbajtura për investim</i>	109,383	114,737	(5,355)	(4.7)%
<i>Mjete të qëndrueshme në proces</i>	44,051	32,948	11,103	33.7 %
Mjete të tjera, neto	3,546,371	2,255,605	1,290,767	57.2 %
<b>TOTALI I AKTIVEVE</b>	<b>225,016,370</b>	<b>225,804,670</b>	<b>(788,300)</b>	<b>(0.3)%</b>

Shenimi: Shifrat janë të pa audituara nga auditoret e jashtëm

## Pasqyra e pozicionit financiar dhe zërat jashtë bilanci (vijon)

në mijë Lekë

DETYRIMET	30/09/2019	31/12/2018	Ndryshimi	ne %
Detyrimet ndaj Bankës Qëndrore	-	-	0	0%
Detyrimet ndaj institucioneve të kreditit përveç B.Qëndrore	8,320,113	8,599,087	(278,974)	(3.2)%
<i>Llogari rrjedhëse</i>	2,080,886	2,588,921	(508,035)	(19.6)%
<i>Depozita</i>	6,239,227	6,010,166	229,061	3.8 %
Detyrimet ndaj klientëve	178,838,788	182,385,757	(3,546,969)	(1.9)%
<i>Llogari rrjedhëse</i>	121,216,837	121,974,827	(757,989)	(0.6)%
<i>Llogari depozite</i>	53,468,013	56,563,953	(3,095,940)	(5.5)%
<i>Të tjera</i>	4,153,937	3,846,977	306,960	8.0 %
Borxhi ndaj Qeverisë shqiptare dhe organizatave publike	328,558	323,724	4,833	1.5 %
Mjete të mbajtura në emër të të tretëve	1,733,384	1,408,881	324,503	23.0 %
<i>Administrimi fiskal</i>	781,803	479,775	302,028	63.0 %
<i>Të tjera</i>	951,581	929,106	22,475	2.4 %
Fond rezervë për huatë standarde dhe në ndjekje	1,015,110	1,018,374	(3,264)	(0.3)%
Fond rezervë për angazhimet dhe për rreziqe të tjera	112,738	111,051	1,687	1.5 %
Borxh i varur	2,783,058	1,702,473	1,080,586	63.5 %
Detyrime të tjera	1,856,072	1,899,629	(43,557)	(2.3)%
<b>TOTALI I DETYRIMEVE</b>	<b>194,987,821</b>	<b>197,448,976</b>	<b>(2,461,155)</b>	<b>(1.2)%</b>
<b>KAPITALI AKSIONAR</b>				
Kapitali aksionar	14,178,593	14,178,593	0	0%
Rezerva e përgjithshme	3,270,838	3,270,838	0	0%
Rezerva rivlerësimi	1,911,419	1,980,334	(68,915)	(3.5)%
Diferenca rivlerësimi	(1,919,015)	(1,787,493)	(131,521)	7.4 %
Fitimet e pashpërndara	8,745,290	4,446,059	4,299,231	96.7 %
(Humbja) / Fitimi i vitit ushtrimor	3,841,424	6,267,364	(2,425,940)	-39%
<b>TOTALI I KAPITALIT AKSIONAR</b>	<b>30,028,549</b>	<b>28,355,694</b>	<b>1,672,855</b>	<b>5.9 %</b>
<b>TOTALI I DETYRIMEVE &amp; KAPITALIT AKSIONAR</b>	<b>225,016,370</b>	<b>225,804,670</b>	<b>(788,300)</b>	<b>(0.3)%</b>

në mijë Lekë

ZËRAT JASHTË BILANCIT	30/09/2019	31/12/2018	Ndryshimi	ne %
Angazhime të dhëna	23,421,894	21,874,040	1,547,854	7.1 %
Angazhime të marra	(464,526)	(448,415)	(16,112)	3.6 %
Veprimet valutore të blera - (të shitura)	130	312	(182)	(58.3)%
Angazhime të tjera	0	0	0	0%

Shenimi: Shifrat janë të pa audituara nga auditoret e jashtëm

## Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve

në mijë Lekë	01/01 deri 30/9/2019	01/01 deri 30/9/2018	Ndryshimi	ne %
<b>Interesat</b>				
Të ardhura nga interesat	5,305,707	5,832,631	(526,924)	(9.0)%
nga veprimet me banka	155,091	97,497	57,595	59.1 %
nga veprimet me klientet	3,489,427	3,606,435	(117,007)	(3.2)%
nga veprimet me letra me vlere të tjera	1,660,589	2,128,017	(467,428)	(22.0)%
	600	683	(83)	(12.2)%
Shpenzime për interesa	(193,137)	(1,156,250)	963,113	(83.3)%
per veprimet me banka	(1,306)	(10,728)	9,422	(87.8)%
per veprimet me klientet	(39,028)	(40,060)	1,032	(2.6)%
per borxhet e varura	(70,750)	(313,307)	242,558	(77.4)%
per veprimet me letra me vlere	(82,053)	(792,155)	710,102	(89.6)%
<b>Te Ardhurat Neto nga Interesat</b>	<b>5,112,570</b>	<b>4,676,381</b>	<b>436,189</b>	<b>9.3 %</b>
Te ardhurat nga komisionet	2,354,809	2,317,397	37,412	1.6 %
nga veprimtaria huadhenese	473,514	442,651	30,863	7.0 %
nga sherbimet bankare	1,881,295	1,874,746	6,549	0.3 %
Shpenzime per komisionet	(641,437)	(515,434)	(126,002)	24.4 %
per veprimtarine huamarrese	(210,334)	(162,568)	(47,766)	29.4 %
per sherbimet bankare	(431,103)	(352,867)	(78,236)	22.2 %
<b>Fitimi Neto nga Komisionet</b>	<b>1,713,372</b>	<b>1,801,963</b>	<b>(88,590)</b>	<b>(4.9)%</b>
Fitimi neto nga veprimtaria valutore	471,684	575,065	(103,380)	(18.0)%
Të ardhura neto nga operacionet e qirasë	4,033	6,239	(2,207)	(35.4)%
Fitimi/(Humbja) neto nga veprimtaritë e tjera bankare	(58,729)	(2,182)	(56,547)	-
<b>Shpenzime të përgjithshme të veprimtarisë</b>	<b>(3,552,767)</b>	<b>(3,813,406)</b>	<b>260,639</b>	<b>(6.8)%</b>
Shpenzime për personelin	(1,780,997)	(1,743,492)	(37,504)	2.2 %
Taksa përveç taksave mbi të ardhurat	(41,835)	(44,774)	2,938	(6.6)%
Shpenzime për shërbime të jashtme	(1,729,936)	(2,025,141)	295,205	(14.6)%
<b>Amortizimi mjeteve të qëndrueshme</b>	<b>(344,060)</b>	<b>(438,029)</b>	<b>93,969</b>	<b>(21.5)%</b>
<b>Humbjet nga llogaritë për t'u arketuar dhe shpenzimet për fondin rezervë për llogaritë e dyshimta</b>	<b>617,667</b>	<b>3,271,332</b>	<b>(2,653,665)</b>	<b>(81.1)%</b>
Rimarrje /(Shpenzime) neto për fondet rezervë statistikore per huate standarte & ne ndjekje	3,264	969,791	(966,527)	(99.7)%
Rimarrje /(Shpenzime) neto për fonde rezervë për huatë nënstandard, të dyshimta dhe të humbura	1,403,282	3,378,955	(1,975,673)	(58.5)%
Rimarrje /(Shpenzime) neto për fonde të tjera rezervë	(194,346)	(182,169)	(12,177)	6.7 %
Humbje nga llogaritë për t'u arkëtuar të pambledhshme	(594,533)	(895,246)	300,712	(33.6)%
<b>Fitimi neto nga veprimtaritë jo te zakonshme</b>	<b>170,210</b>	<b>(181,376)</b>	<b>351,586</b>	<b>(193.8)%</b>
Të ardhura jo te zakonshme	174,387	133,238	41,149	30.9 %
Shpenzime jo të zakonshme	(4,176)	(314,613)	310,437	(98.7)%
<b>Fitimi (Humbja) para tatimit</b>	<b>4,133,981</b>	<b>5,895,987</b>	<b>(1,762,007)</b>	<b>(29.9)%</b>
Tatimi mbi fitimin	(292,557)	(535,154)	242,597	(45.3)%
<b>Fitimi / (Humbja) neto per periudhen</b>	<b>3,841,424</b>	<b>5,360,834</b>	<b>(1,519,410)</b>	<b>(28.3)%</b>

Shenimi: Shifrat jane te pa audituara nga auditoret e jashtem

## Të ardhurat dhe shpenzimet sipas tremujorëve

në mijë Lekë	T3-2018	T4-2018	T1-2019	T2-2019	T3-2019
<b>Interesat</b>					
Të ardhura nga interesat	1,792,820	1,840,690	1,765,014	7,180,836	(3,640,143)
<i>nga veprimet me banka</i>	37,866	44,857	48,982	186,536	(80,427)
<i>nga veprimet me klientet</i>	1,150,328	1,174,523	1,136,393	4,631,217	(2,278,183)
<i>nga veprimet me letra me vlere të tjera</i>	604,227	621,178	579,484	2,362,276	(1,281,172)
	399	132	154	806	(361)
Shpenzime për interesa	(103,793)	(46,678)	(59,660)	(274,528)	141,050
<i>per veprimet me banka</i>	(141)	(661)	(626)	(1,845)	1,164
<i>per veprimet me klientet</i>	(12,977)	(12,756)	(12,658)	(51,576)	25,205
<i>per borxhet e varura</i>	(82,531)	(24,099)	(23,614)	(153,825)	106,689
<i>per veprimet me letra me vlere</i>	(8,144)	(9,162)	(22,763)	(67,282)	7,991
<b>Te Ardhurat Neto nga Interesat</b>	<b>1,689,027</b>	<b>1,794,011</b>	<b>1,705,355</b>	<b>6,906,308</b>	<b>(3,499,093)</b>
Te ardhurat nga komisionet	909,720	721,443	708,381	3,120,918	(1,474,490)
<i>nga veprimtaria huadhënëse</i>	216,107	148,981	148,735	685,437	(360,659)
<i>nga shërbimet bankare</i>	693,614	572,462	559,645	2,435,481	(1,113,831)
Shpenzime per komisionet	(190,912)	(203,462)	(160,094)	(759,611)	278,268
<i>per veprimtari huamarrëse</i>	(66,163)	(67,397)	(57,589)	(254,652)	101,908
<i>per shërbimet bankare</i>	(124,749)	(136,065)	(102,504)	(504,959)	176,360
<b>Fitimi nga komisionet, neto</b>	<b>718,808</b>	<b>517,981</b>	<b>548,287</b>	<b>2,361,307</b>	<b>(1,196,222)</b>
Fitimi neto nga veprimtaria valutore	202,723	232,301	137,961	709,382	(375,658)
Të ardhura neto nga operacionet e qirasë	1,956	1,353	1,304	5,996	(3,267)
Fitimi/(Humbja) neto nga veprimtari e tjera bankare	39,256	(18,856)	(74,936)	59,118	(42,911)
<b>Shpenzime të përgjithshme të veprimtarisë</b>	<b>(1,242,621)</b>	<b>(1,263,802)</b>	<b>(1,138,414)</b>	<b>(4,916,358)</b>	<b>2,502,004</b>
<i>Shpenzime për personelin</i>	(598,058)	(659,513)	(562,434)	(2,412,564)	1,194,002
<i>Taksa përveç taksave mbi të ardhurat</i>	(1,633)	(1,713)	(8,269)	(43,009)	9,442
<i>Shpenzime për shërbime të jashtme</i>	(642,931)	(602,576)	(567,710)	(2,460,785)	1,298,560
<b>Amortizimi mjeteve të qëndrueshme</b>	<b>(126,251)</b>	<b>(127,463)</b>	<b>(129,670)</b>	<b>(482,770)</b>	<b>268,381</b>
<b>Humbjet nga llogarite per t'u arketuar dhe shpenzimet për fondin rezervë per llogarite e dyshimta</b>	<b>394,143</b>	<b>(289,617)</b>	<b>330,278</b>	<b>554,078</b>	<b>(266,689)</b>
<i>Rimarrje /(Shpenzime) neto për fondet rezervë statistikore per huatë standarte &amp; ndjekje</i>	407,350	(56,077)	5,928	373,184	(375,849)
<i>Rimarrje /(Shpenzime) neto për fonde rezervë për huatë nënstandard, të dyshimta dhe të humbura</i>	510,491	302,355	545,047	1,433,577	(575,342)
<i>Rimarrje /(Shpenzime) neto për fonde të tjera rezervë</i>	(94,528)	(75,581)	(57,693)	(291,037)	154,384
<i>Humbje nga llogaritë për t'u arketuar të pambledhshme</i>	(429,170)	(460,314)	(163,005)	(961,646)	530,117
<b>Fitimi neto nga veprimtaritë jo te zakonshme</b>	<b>(62,209)</b>	<b>23,397</b>	<b>58,101</b>	<b>51,813</b>	<b>60,297</b>
<i>Të ardhura jo te zakonshme</i>	28,275	25,818	59,275	146,917	(31,805)
<i>Shpenzime jo të zakonshme</i>	(90,484)	(2,420)	(1,174)	(95,104)	92,101
<b>Fitimi (Humbja) para tatimit</b>	<b>1,614,832</b>	<b>869,306</b>	<b>1,438,265</b>	<b>5,248,873</b>	<b>(2,553,158)</b>
Tatimi mbi fitimin	(159,168)	101,662	(185,922)	(293,806)	187,171
<b>Fitimi (Humbja) neto per periudhen</b>	<b>1,455,664</b>	<b>970,968</b>	<b>1,252,344</b>	<b>4,955,068</b>	<b>(2,365,987)</b>

Shenimi: Shifrat jane te pa audituara nga auditoret e jashtem

## Pasqyra e ndryshimeve të kapitalit

në mijë Lekë	Kapitali aksionar	Rezerva e përgjithshme	Rezerva ligjore	Rezerve rivleresimi ndertesat	Diferenca rivlerësimit	Fitimi i pashpërndarë	Fitimi i periudhes	Totali
<b>Gjendja më: 01/01/2019</b>	<b>14,178,593</b>	<b>1,852,979</b>	<b>1,417,859</b>	<b>1,980,334</b>	<b>(1,787,493)</b>	<b>4,446,059</b>	<b>6,267,364</b>	<b>28,355,694</b>
Kalim ne fitim i pashperndare	0	0	0	0	0	6,267,364	(6,267,364)	0
Diference Rivleresimi Kapitali	0	0	0	0	(131,521)	0	0	(131,521)
Rezerve rivleresimi per ndertesat	0	0	0	(68,915)	0	(3,922)	0	(72,837)
Pagese dividendi	0	0	0	0	0	(1,964,211)	0	(1,964,211)
Fitimi (Humbja) neto për periudhen	0	0	0	0	0	0	3,841,424	3,841,424
<b>Gjendja më: 30/9/2019</b>	<b>14,178,593</b>	<b>1,852,979</b>	<b>1,417,859</b>	<b>1,911,419</b>	<b>(1,919,015)</b>	<b>8,745,290</b>	<b>3,841,424</b>	<b>30,028,549</b>

në mijë Lekë	Kapitali aksionar	Rezerva e përgjithshme	Rezerva ligjore	Rezerve rivleresimi ndertesat	Diferenca rivlerësimit	Fitimi i pashpërndarë	Fitimi i periudhes	Totali
<b>Gjendja më: 01/01/2018</b>	<b>14,178,593</b>	<b>1,852,979</b>	<b>1,417,859</b>	<b>1,496,753</b>	<b>(830,702)</b>	<b>3,316,579</b>	<b>5,223,164</b>	<b>26,655,224</b>
Kalim ne fitim i pashperndare	0	0	0	0	0	5,223,164	(5,223,164)	0
Diference Rivleresimi Kapitali	0	0	0	0	(668,650)	0	0	(668,650)
Rezerve rivleresimi per ndertesat	0	0	0	(91,495)	0	48,239	0	(43,256)
Pagese dividendi	0	0	0	0	0	(2,756,842)	0	(2,756,842)
Fitimi (Humbja) neto për periudhen	0	0	0	0	0	0	5,360,834	5,360,834
<b>Gjendja më: 30/9/2018</b>	<b>14,178,593</b>	<b>1,852,979</b>	<b>1,417,859</b>	<b>1,405,258</b>	<b>(1,499,352)</b>	<b>5,831,140</b>	<b>5,360,834</b>	<b>28,547,311</b>

## Pasqyra e rrjedhjes së parasë në mijë Lekë

	01/1 deri 30/9/2019	01/1 deri 30/9/2018
<b>Flukset monetare nga aktiviteti operacional</b>		
<b>Fitimi i vitit ushtrimor</b>	<b>3,841,424</b>	<b>5,360,834</b>
<b>2. Zera Jo-Monetar ne pasqyren e rrjedhjes se parase</b>		
Zhvleresimi / amortizimi	412,975	438,029
Mjeteve te qendrueshme nxjerre jashte bilanci	15,492	(57,734)
Shpenzimet për fondet rezervë (Transferime nga fondet rezerve)	3,190,357 (4,421,704)	5,218,209 (9,258,733)
(Rritje)/Paksim ne interesat per t'u arketuar	(38,658)	557,404
Rritje/(Paksim) ne interesat per t'u paguar	21,368	(139,213)
Efekti i zërave të tjerë të përlogaritur dhe të shtyrë	(63,383)	156,138
Diferenca e rivlerësimit	(131,521)	(668,650)
<b>3. Rrjedhja e parase nga aktiviteti operacional perpara ndryshimeve ne kapitalin qarkullues (1+2)</b>	<b>2,826,348</b>	<b>1,606,285</b>
<b>4. Ndryshime ne kapitalin qarkullues</b>		
(Rritje) /renie ne Bonot e thesarit dhe bonot e tjera te pershtatshme	(536,018)	(536,496)
